



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

GLAVNI CENTAR PORODIČNE MEDICINE • MAIN FAMILY HEALTH CENTRE

Nr.Protokoli: 1612/1

Data: 04.11.2020

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës 03/L-212, Nenit 5 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetsisë ,nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 Për Rregullimin e Procedurave Të Konkursit në Sektorin Publik, Qendra Kryesore e Mjeksisë Familjare në Pejë, publikon:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

Titulli i vendit të punës:

1. Mjek/e Specialist/e i/e mjeksisë Familjare, një (1) pozitë: Në QMF. II

Nëpunësi mbikqyrës: Udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Familjare

2. Mjek/e Specialist/e nga Paradontologjia me mjekim oral ,një (1) pozitë: Në Sektorin e Shëndetit oral.

Nëpunësi mbikqyrës: Udhëheqësi i Sektorit të Shëndetit oral.

3. Doktor/e i/e mjeksisë ,shtatë (7) pozita: Në Punte të QKMF (Sipas nevojës)

Nëpunësi mbikqyrës: Udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Familjare.

4. Infermier/e i/e pediatriisë, tri (3) pozita: Në Sektorin Konsultativ.

Nëpunësi mbikqyrës: Shefi i sektorit konsultativ.

5. Mami një (1) pozitë: Në QMF - III.

Nëpunësi mbikqyrës: Shefi i Njesisë.

6. Punëtorë/e ndihmës/e një (1) Pozitë:Në Shërbimin Teknik

Nëpunësi mbikqyres: Shefi i Njesisë/ shërbimit.

Paga mujore Për pozitën e parë::

659.7 €

Paga mujore Për pozitën e dytë::

659.7 €

Paga mujore Për pozitën e tretë::

565.5 €

Paga mujore Për pozitën e katërt::

377.0 €

Paga mujore Për pozitën e pestë::

377.0 €

Paga mujore Për pozitën e gjashtë::

314.1 €

Orari i punës:

40 orë në javë (orar i plotë)

Kohëzgjatja e emërimit:

Në kohë të pacaktuar

Puna provuese:

3 muaj

Detyrat e punës dhe përgjegjësitë për pozitën me nr. Rendor 1 – Mjek Specialist i mjeksisë Familjare:

- Ofron shërbime me standard të lartë bazuar në mjeksinë e bazuar në dëshmi.
- Ofron shërbime gjithpërfshirëse për individin/pacientin dhe familjen në të gjitha epizodet e jetës.
- Harton planin e trajtimit të sëmundjes dhe trajton pacientin si figurë qendrore.
- Përcakton diagnozë diferenciale dhe diagnozën e punës në përputhje me simptomatologjinë.
- Bën zbulimin e hershëm të shtazënisë , ofron kujdes antenatal dhe kujdeset për planifikim familjar.
- Kujdeset për shëndetin e fëmijëve përmes menaxhimit të integruar të sëmundjeve të fëmijëve sipas (MISF), përcjelljes sistematike të rritjes dhe zhvillimit të foshnjave dhe fëmijëve, si dhe kujdesit për adoleshentë dhe tinejxher.
- Kujdeset për shëndetin e meshkujve.
- Ofron kujdes për shëndetin e të moshuarve dhe kujdes paliativ.
- Bën identifikimin e hershëm të shenjave alarmuese që sigurojnë kujdes të përshtatshëm dhe të ofrojnë kujdes të vazhdueshëm për pacient me çrregullime të shëndetit mendor.
- Ofron kujdes në rastet urgjente, dhe i referon rastet me kohë dhe në mënyrë adekuate.
- Kujdeset për lëndimet e vogla (kirurgjia e vogël)
- Interpreton rezultatet e testeve të shpejta laboratorike,komunikon rezultatet në përshtatje me kornizën kohore.
- Bën edhe hulumtime tjera diagnostifikuese varësisht nga kompetecat e fituara me programe specifike të EVM.
- Komunikon ose konsultohet me specialist të niveleve të tjera sipas nevojës.
- Referon pacientin për kujdes spitalor dhe kërkon informatën kthyesë për përcjelljen e pacientit.
- Kujdesi i vazhdueshëm shëndetsorë përfshirë vizitat shtëpiake.
- Kujdesi i vazhdueshëm për pacientët më sëmundje kronike jo ngjitëse dhe programe kontrolluese për sëmundjet kronike jo ngjitëse (Hipertetnsioni,astma,Diabeti,Sëmundjet malinje,Sëmundjet kardiovaskulare,Sëmundjet e shëndetit mendor, të tjera)
- Kontrolli i sëmundjeve ngjitëse n(hulumtimet epidemiologjike(TB,Hepatit, Sëmundjet seksualisht transmiseve, HIV/AIDS, Të tjera)
- Promovimi shëndetsorë dhe parandalimi i sëmundjeve si dhe shërbimet në komunitete (Grupet vulnerable, vendet rurale, shkolla, komunitete);
- Zbatimi i Programit të vaksinimit
- Edukimi shëndetsorë
- Inkurajon punën ekipore ,(mjekun e përgjithshëm, stomatologun, infermieret familjare, infermieret në komunitet dhe asistent të stomatologut)
- Vlerëson efektivitetin e kujdesit të ofruar nga ekipi i mjeksisë familjare, Identifikon problemet dhe udhëheq anëtarët e ekipit për zgjidhjen e tyre.
- Përcakton anëtarët e ekipit në përputhje me nevojat e pacientit , aftësitë dhe kualifikimet e stafit për të përmbushur nevojat e institucionit.
- Merr pjesë në trajnime, vlerësim të kompetencave, orientim dhe edukim për të punësuarit e rinj.
- Komunikon qartë , saktë dhe kontribon në krijimin e klimës së mirë të punës që rritë kënaqshmëritë në punë të përsonelit.
- Shërben si burim i njohurive dhe shkathtësive për anëtarët tjerë të ekipit për të shkëmbyer përvojat klinike.
- Krijimin e Listës së pacientëve sipas moshës dhe gjinisë dhe plotësimi i rregullt dhe i saktë i dosjeve mjekësore ku përfshihiën edhe caktimi i vizitave të rregullta për pacientët.
- Evidenton dhe raporton rastet e sëmundjeve infektive, sëmundjet kronike jo masovike dhe sëmundjeve malinje inë Institutin Kombëtarë të Shëndetit Publik.
- Vepron në mënyrë profesionale duke rrespektuar rregulloret për KPSH dhe vepron në përputhje me të gjitha rregulloret procedurat dhe politikat e MSH në fuqi.
- Përcakton diagnozën përfundimtare dhe përshkruan terapinë
- Nështrohet programit nacional të Edukimit të Vazhdueshëm mjksor
- Përkujdeset për konfidencialitetin e individit.
- Përcjellja e sëmundshmërisë.
- Identifikimi i grupeve të veçanta të rrezikut.
- Merr pjesë në grupet e rishqyrtimit kolegjial dhe sjellë vendime të përbashkëta për menaxhimin e sëmundjeve.
- Merr pjesë edhe në harimin e protokolleve klinike,
- Merr pjesë në takime , konferenca dhe tregon interesin në zhvillimin e strategjive për përmirësim të intervenimeve klinike dhe nivelit të lartë të kujdesit ndaj pacientit.
- Demonstron shkathtësi të larta klinike profesionale.
- Tregon aftësi për zbatim të vazhdueshëm të detyrave të punës sipas PVP,
- Tregon përkushtim për ngritjen profesionale dhe përmirësimin e kompetencave
- Respekton plotësisht konfidencialitetin.
- Shkrimi duhet të jetë i qartë dhe i lexueshëm.
- Respekton dhe i përmbahet protokoleve klinike, si dhe procedurave administrative në fuqi.
- Organizon punën në vendin e punës,
- Kryen edhe punë tjera të ngjashme në kuadër të Ligjit Për Shendetësi të caktuara nga ana e eprorit.

Kualifikimi, pervoja dhe aftësitë për pozitën me nr. Rendor 1 – Mjek specialist i mjeksisë familjare::

- Të kanë të kryer Specializimin nga Mjeksia Familjare .
- Të kanë licencën valide të punës.
- Të njofin punën me kompjuter (e dëshirueshme),
- Njohja e dygjuhësisë (e dëshirueshme).

Detyrat e punës dhe përgjegjësitë për pozitën me nr. Rendor 2 – Mjek Specialist nga Paradontologjia me mjekim oral:

- Ofrimi i shërbimeve stomatologjike të kualitetit të lartë.
- ofrimi efektiv i shëbimeve stomatologjike,
- sigurimi i kujdesit shëndetësor stomatologjik për të gjithë popullatën,
- ndihmon dhe koordinon bashkëpunimin efektiv ndërmjet shërbimeve stomatologjike,
- përkrah dhe zbaton normat në lëminë e shëndetit oral të përpiluara nga Ministria e Shëndetësisë,
- ndihmon dhe zhvillon sistemin informativ stomatologjik në kuadër të shërbimeve stomatologjike,
- bën trajtimin e paradonciumit të sëmurë me metodat përkatëse,
- identifikon dhe menjanon vatrat fokale,
- kryen intervenimet kirurgjike të paradonciumit të sëmurë,
- trajton sëmundjet lokale dhe të përgjithshme që reflektohen në gojë të pacientit.
- Kryen edhe detyra tjera nga lëmia e vet profesionale.
- Respekton konfidencialitetin, dhe trajton të gjithë barabartë pa dallim.
- Respekton dhe i përmbahet protokoleve klinike, si dhe procedurave administrative në fuqi.
- Organizon punën në vendin e punës,
- Kryen edhe punë tjera të ngjashme në kuadër të Ligjit Për Shendetësi të caktuara nga ana e eprorit.

Kualifikimi, pervoja dhe aftësitë për pozitën me nr. Rendor 2 – Mjek Specialist nga Paradontologjia me mjekim oral :

- Të kanë të kryer Specializimin nga Paradontologjia me mjekim oral.
- Të kanë licencën valide të punës.
- Të njofin punën me kompjuter (e dëshirueshme),
- Njohja e dygjuhësisë (e dëshirueshme).

Detyrat e punës dhe përgjegjësitë për pozitën me nr. Rendor 3 – Doktor i mjeksisë:

- **Praktikon në përputhje me kodin etik dhe zbaton procesin e kujdesit infermior të dokumentuar.**
- Ofron shërbime me standard të lartë bazuar në mjeksinë e bazuar në dëshmi.

- Ofron shërbime gjithpërfshirëse për individin/pacientin dhe familjen në të gjitha epizodet e jetës, nën mbikqyrjen e Mjekut Familjar.
- Harton planin e trajtimit të sëmundjes dhe trajton pacientin si figurë qendrore nën mbikqyrjen e mjekut familjar.
- Përcakton diagnozë diferenciale dhe diagnozën e punës në përputhje me simptomatologjinë.
- Përcjellja sistematike e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve dhe adoleshentëve.
- Kujdesi për personat e moshuar dhe në nevojë,
- Ofron kujdes në rastet urgjente dhe i referon rastet me kohë dhe në mënyrë adekuate,
- Interpreton rezultatet e testeve të shpejta laboratorike,
- Komunikon ose konsultohet me Specialist të mjeksisë familjare sipas nevojës,
- Referon pacientin te specialisti i mjeksisë familjare dhe për kujdes spitalor,
- Kujdes i vazhdueshëm për pacientët me sëmundje kronike jo ngjitëse,
- Kontrolli i sëmundjeve ngjitëse (hulumtimet epidemiologjike),
- Promovimi shëndetsorë dhe parandalimi i sëmundjeve si dhe shërbimet në komunitete(grupet vulnerable, vendet rurale, shkolla, komunitete).
- Zbatimi i programit të vaksinimit,
- Edukimi shëndetsorë etj
- Inkurajohet nga puna ekipore (mjeku familjar, infermieret familjare, infermieret në komunitet)
- Vlerëson efektivitetin e kujdesit të ofruar nga ekipi i mjeksisë familjare , identifikon problemet dhe kërkon nga anëtarët e ekipit zgjedhjen e tyre,
- Përcaktohet nga mjeku familjar si pjesë e ekipit të mjeksisë familjare në përputhje me nevojat e pacientit , aftësitë dhe kualifikimet, për të përmbushur nevojat e institucionit.
- Merr pjesë në trajnime , vlerësim të kompetencave , orientim dhe edukim
- Komunikon qartë , saktë dhe krijon klimë të mirë për punë që rritë kënaqshmëritë në punë,
- Vepron në mënyrë profesionale duke rrespektuar rregulloret për KPSH dhe vepron në përputhje me të gjitha rregulloret, procedurat dhe politikat e MSH në fuqi.
- Përcakton diagnozën përfundimtare dhe përshkruan terapinë
- Nështrohet programit nacional të zhvillimit të vazhdueshëm profesional,
- Përkujdeset për konfidencialitetin e individit.
- Përcjellja e sëmundshmërisë, nën mbikqyrjen e mjekut familjarë,
- Identifikimi i grupeve të veçanta të rrezikut.
- Merr pjesë në grupet e rishqyrtimit kolegjial dhe sjellë vendime të përbashkëta për menaxhimine sëmundjeve.
- Ndhimon mjekun familjar në zhvillimin e auditeve mjeksore në institucionin përkatës ,
- Merr pjesë në takime , konferenca dhe tregon interesin në zhvillimin e strategjive për përmirësim të intervenimeve klinike dhe nivelit të lartë të kujdesit ndaj pacientit.
- Demonstron shkathtësi optimale klinike profesionale
- Tregon aftësi për zbatim të vazhdueshëm të detyrave të punës sipas PVP,
- Tregon përkushtim për ngritjen profesionale dhe përmirësimin e kompetencave.
- Respekton plotësisht konfidencialitetin.
- Shkrimi duhet të jetë i qartë dhe i lexueshëm.
- Respekton dhe i përmbahet protokoleve klinike, si dhe procedurave administrative në fuqi.
- Organizon punën në vendin e punës
- Kryen edhe punë tjera të ngjashme në kuadër të Ligjit Për Shendetësi të caktuara nga ana e eprorit.

Kualifikimi, pervoja dhe aftësitë për pozitën me nr. Rendor 3 – Doktor i mjeksisë:

- Të kanë të kryer Fakultetin e mjekësisë –drejtimi i përgjithëshëm
- Të kanë licencën valide të punës..
- Të njofin punën me kompjuter (e dëshirueshme),
- Njohja e dygjuhësisë (e dëshirueshme).

Detyrat e punës dhe përgjegjësitë për pozitën me nr. Rendor 4 – Infermier i pediatriisë:

- do të punoj si pjestar i ekipit të kujdesit mjekësor, në ofrimin e standardit më të lartë të kujdesit shëndetësor të përqëndruar në pacientin, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurtë për pacientët
- Siguron kujdes për nënat dhe foshnjat duke e informuar mjekun për problemet evtuale, vaksinimin dhe imunizim.
- të caktoj, planifikoj, implementoj dhe vlerësoj kujdesin ndaj të sëmurit në përputhje me politikën e aprovuar,
- të kolektoj të dhëna të sakta mbi pacientin sipas specifikave të infermierit, teknikut përgjegjës,
- të kontribuoj në krijimin e një mjedisi të sigurtë klinik për të gjithë pacientët dhe kolegët,
- të siguroj komunikim të mirë gjatë dorëzimit të detyrës pas orarit të punës si dhe të dhëna të sakta për pacientët për të cilët është kujdesur gjatë orarit të punës,
- tu japë pacientëve informata të sakta dhe të qarta lidhur me kujdesin i cili u ofrohet atyre,
- të administroj terapinë e përshkruar në përputhje me politikën institucionale,
- të përdorë dhe mirëmbajë në mënyrë të duhur dhe të sigurtë të gjitha pajisjet,
- të administroj terapinë e përshkruar në harmoni me politikën institucionale.
- Respekton dhe i përmbahet protokoleve klinike, si dhe procedurave administrative në fuqi.
- Kryen edhe punë tjera të ngjashme në kuadër të Ligjit Për Shendetësi të caktuara nga ana e eprorit.

Kualifikimi, pervoja dhe aftësitë për pozitën me nr. Rendor 4 – Infermier i pediatriisë:

- Shkolla e mesme /Bachelor –drejtimi i pediatriisë. (Me mundësi të barabarta konkurimi).
- Të kanë licencën valide të punës.
- Të njofin punën me kompjuter (e dëshirueshme),
- Njohja e dygjuhësisë (e dëshirueshme).

Detyrat e punës dhe përgjegjësitë për pozitën me nr. Rendor 5 – Mami:

- Do të punoj si pjestar i ekipit të kujdesit mjekësor, në ofrimin e standardit më të lartë të kujdesit shëndetësor të përqëndruar në pacientin, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurtë për pacientët.
- të caktoj, planifikoj, implementoj dhe vlerësoj kujdesin ndaj të sëmurit në përputhje me politikën e aprovuar,
- të kolektoj të dhëna të sakta mbi pacientin sipas specifikave të mamisë, teknikut përgjegjës,
- të kontribuoj në krijimin e një mjedisi të sigurtë klinik për të gjithë pacientët dhe kolegët,
- të siguroj komunikim të mirë gjatë dorëzimit të detyrës pas orarit të punës si dhe të dhëna të sakta për pacientët për të cilët është kujdesur gjatë orarit të punës,
- tu japë pacientëve informata të sakta dhe të qarta lidhur me kujdesin i cili u ofrohet atyre,
- të administroj terapinë e përshkruar në përputhje me politikën institucionale,
- të përdorë dhe mirëmbajë në mënyrë të duhur dhe të sigurtë të gjitha pajisjet,
- të administroj terapinë e përshkruar në harmoni me politikën institucionale.
- Siguron kujdesje antenatale paranatale për nënat dhe foshnjët
- Siguron kujdes për nënat dhe foshnjat antenatal paranatal duke e informuar mjekun për problemet evtuale,
- Monitoron dhe shënon të dhënat mbi shenjat vitale,
- Reanimon nënën dhe foshnjën në rast nevoje,
- Merr mostrat e gjakut për analiza laboratorike,
- Ofron këshilla lidhur me gjendjen dhe e inkurajon atë,
- Monitoron shenjat vitale dhe ndërmerr masat adekuate në rast nevoje,
- Respekton dhe i përmbahet protokoleve klinike, si dhe procedurave administrative në fuqi.
- Te kryej edhe detyra tjera te caktuara nga mbikqyrësi.

Kualifikimi, pervoja dhe aftësitë për pozitën me nr. Rendor 5 – Mami:

- Shkolla e mesme /Bachelor –drejtimi Mami. (Me mundësi të barabarta konkurimi)
- Të kanë licencën valide të punës.
- Të njofin punën me kompjuter (e dëshirueshme),
- Njohja e dygjuhësisë (e dëshirueshme).

Detyrat e punës dhe përgjegjësitë për pozitën me nr. Rendor 6 – Punëtorë/e ndihmëse

- Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e objekteve të punës mbrenda, jashtë dhe përreth objektit,kujdeset per pastrimin e rrobave dhe elementeve te tjera per te cilat ngarkohet nga eprori.
- Përkujdeset për mirëmbajtje të rregullt të:
- Objekteve dhe mjeteve te punës,
- Kontrollon gjendjen brenda objektit,
- Bën ajrosjen e objektit,
- Bën pastrimin dhe dezinfektimin e brendshëm të objektit,
- Bën pastrimin e jashtëm të objektit dhe rreth objektit,
- Përkujdeset për materialin higjieniko sanitar dhe harxhues,
- Ka për obligim bashkëpunimin e ngushtë me shërbimet përkatëse dhe eprorët e vet,
- I përgjigjet çdo kërkesë për punë në domenin e vet,
- Bën kërkesë për mjetet që i nevoiten,
- Përgjigjet që punët të kryhen në afat kohor të paraparë,
- Kryen edhe pune tjera te percaktuara nga udhëheqësi.

Kualifikimi, pervoja dhe aftësitë për pozitën me nr. Rendor 6 – Punëtorë/e ndihmëse

Të kanë të kryer shkollën e mesme

- Të njofin punën me kompjuter.
- Njohja e dygjuhësisë (e dëshirueshme)
- Përvojë e punës (e dëshirueshme)

Kushtet e aplikimit:

Kandidatët që konkurojnë për këto vende të punës,kërkesës (aplikacionit),duhet të ja bashkangjesin edhe këto dokumente:

- Dëshmin e kualifikimit në kërkuara me konkurs.(Diploma , Certifikata) ;
- Licencën e punës të lëshuar nga Institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës (Përveç për pozitën me nr. Rendor 6).
- Çertifikatën e lindjes ,
- Fotokopjen e letërnjoftimit ,
- Çertifikatën që ndaj tij /saj nuk zbatohen hetimet ,

Kërkesat (Aplikacionet) mirrën në QKMF – Pejë, dhe dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në arken e QKMF-së Pejë. Për informata më të hollësishme mund të informoheni në Zyrën e personelit të QKMF , nr. 49 apo në nr. Tel 039-423-424 çdo ditë pune deri në orën 14:00. Dokumentacioni i cili i bashkangjitet aplikacionit duhet të jetë fotokopje dhe se i njëjti nuk kthehet. Kandidatët te cilët perzgjedhen ,pas shpalljes së njoftimit publik ,duhet te sjellin dokumentet originale , si dhe certifikatën mbi gjendjen shëndetsore. Dokumentet e pakompletuara dhe të cilat nuk i pergjigjen kerkesave te konkursit,si dhe dokumentacioni qe mbërin me vonesë nuk do të merret në shqyrtim .

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

ZV. DREJTORI I QKMF
Dr.Myrvete Salihi